



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 43 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 27/04 / 2022

VENDIM

Nr.10, datë 27 /04/2022

PËR

RAPORTIN VJETOR TË VITIT 2021 PËR OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE KONTROLLIN E DIGAVE TË BOVILLËS DHE LIQENIT ARTIFICIAL TË TIRANËS QË SHFRYTËZOHEN NGA NDËRMARRJA E UJËSJELLËS - KANALIZIMEVE TIRANË

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 27.04.2022 mori në shqyrtim Raportin vjetor për vitin 2021 në lidhje me Shfrytëzimin, Monitorimin dhe Sigurinë e digave të mëdha të Bovillës dhe liqenit artificial të Tiranës që shfrytëzohen nga Ndërmarrja e Ujësjetllës - Kanalizimeve Tiranë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ardhur rezultonte se gjëndja aktuale për mirëmbajtjen, monitorimin dhe sigurinë e tyre është problematike dhe kërkon marrjen e masave të duhura nga shfrytëzuesi i tyre për përmirësimin e monitorimit dhe sigurisë së këtyre digave. Konkretisht për të dy digat nuk ka plane të gadishmërisë në rastet emergjencave civile. Në digën e liqenit Artificial të Tiranës nuk ka monitorim në të dy digat .

Konkretisht, Pas diskutimeve të të gjithë antarëve, KKDM

VENDOSI:

- 1- Ti kërkoje Ndërmarrjes se Ujësjetllës - Kanalizimeve Tiranë dhe Bashkisë Tiranë
 - Të hartojë dhe të dorëzoj për miratim brenda muajit Korrik 2022, pranë KKDM **projektin e zbatimit për rehabilitimin e sistemit të shkarkimit dhe të ujëlëshuesit të digës së liqenit artificial të Tiranës**
 - Të hartojë dhe të dorëzojë brenda muajit Korrik 2022, pranë KKDM **projektin e zbatimit për monitorimin e digës së liqenit artificial të Tiranës**. Brenda Muajit Tetor 2022, të kryhen matjet në sistemin e monitorimit gjeodezik dhe të dorëzohet pranë KKDM baza e të dhënave të matura përmes sistemeve të monitorimit të instaluar në digë.
 - Të kryejë matjet batimetrike për llogarotjen e volumit aktual të ujit në liqenin artificial të Tiranës dhe të hartoj kurben aktuale të volumeve dhe të sipërfaqes së ujit në liqen
 - Të hartojë dhe të dorëzoj për shqyrtim në KKDM, brenda muajit Tetor 2022, **Planin e gadishmërisë në rastet e emergjencave civile (PGREC) për ndonjë prishje të mundshme të digës së Bovillës dhe digës së liqenit artificial të Tiranës**. Ky plan duhet të hartohet në bazë të ligjit Nr.45, datë 18.07.2019 "Për mbrojtjen Civile", Udhëzimit Nr. 248, datë 28.01.2000 "Për hartimin e Planit të Alarmit si dhe Vendimit të KKDM Nr. 5, datë 16.11.2020 "Për planet e gadishmërisë në rastet e emergjencave civile". PGREC duhet të përmbajë llogaritjen e valës shkatërruese duke dhënë kohën, sipërfaqen, shpejtësinë dhe thellësinë e kësaj vale në zonën poshtë digës, hartën e përmbytjes së zonës poshtë digës të bazuar në zhvillimin aktual urban të kësaj zone, skenaret e mundshëm të emergjencave



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- Të instalohet sistemi i monitorimit të masivit të rrëshqitjes në afërsi të digës së Bovillës dhe brenda muajit tetot 2022 të pregatitet një Raport gjeologo - inxhinierik në lidhje me të dhënat e masivit rrëshqitës të evidentuar në anën e djathtë të digës si dhe analiza e matjeve të kryera me instrumentat përkatës të monitorimit të këtij masivi rreëshqitës.
- Të pregatit dhe të dorëzoj për shqyrtim brenda muajit Tator 2022 në KKDM Raportin e vlerësimit dhe menaxhimit të aseteve të digave të Bovillës dhe të liqenit artificial të Tiranës. Ky Raport duhet të përfshijë informacion për gjëndjen aktuale të digave dhe të performancave të tyre, jetën e shërbimit të mbetur rreziqet që kanë këto diga dhe vlerësimin e tyre si dhe planin strategjik për sigurinë, monitorimin dhe mirëmbajtjen e tyre.
- Të instalojë pranë digës së Bovillës dhe digës së Liqenit Artificial të Tiranës stacion hidrometeorologjik me transmetim të dhënash në kohë reale dhe online.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë Vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

